



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Nr. _____ Prot.

Berat, më ____/____/ 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Ndërtim çatie në godinat arsimore - shkolla Rroshnik

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7
Punë ndërtimi, cati -44112400-2

VLERA E FONDIT LIMIT: _____ **4,305,563.76** (kater milion e tre qind e pese mijë e peseqind e gjashtedhje e tre presje shtatedhjete e gjashte) leke pa Tvsh, **Monedha, lek**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen që ka në këtë bashkim operatorësh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, behet duke iu referuar parashikimit në nenit 41 të Ligjit nr. 1009/2009 i ndryshuar : Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

- a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;
- b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:
 - i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;
 - ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;
 - iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin e fundit (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësiti Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 2. Situacionin përfundimtar të objektit;
 3. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

2.3.2/a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP2 -A “Ndërtime civile dhe industriale”
- N.P-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur ne SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 2	“Ndërtime civile dhe industriale”	Ne kete kategori perfshihet grupzeri - Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla vendi	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Ne kete kategori perfshihet grup zeri - Ulluk shkarkimi vertikal dhe horizontal me llamarine xingat Ø 100	A (0- 20 milionë lekë)	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008 , i ndryshuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

2.3.2 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 1(nje)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare dhe Cv.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

• **Inxhinieri i Ndërtimit.**

Eshte kerkuar 1 inxhinier ndertimi i cili do te jete pergjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e punimeve I cili do jete dhe drejtuesi teknik

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Karpentier 2 (dy)
- Karpentier/ Marangoz 1 (nje)
- Punetore ndihmes 3 (tre)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e pikës 2.3.6, të kritereve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Vendosja e ketyre kritereve per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te caktuar i cili kerkon fuqi punetore dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te punes.

-Karpentier (2)

Janë kërkuar 2 karpentier bazuar në zërat e preventivit, Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla vendi; Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100; Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm.

-Karpentier/ Marangoz (1)

Eshte kerkuar 1 karpentier ose marangoz qe ben te mundur lidhjen dhe fiksimin e elementeve per te siguruar qendrueshmerine e struktures.

-Punetore ndihmes (3)

Jane kerkuar 3 puntore te thjeshte per punime te ndryshme sipas te gjitha zerave ne preventiv.

- c) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës c) të pikës 2.3.3, të kritereve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

d)Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre *1 (një) ekspert zjarrefikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH.*

Gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrefikës te jete i pajisur me License Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën individuale të punës;
- certifikatë/dëshmi kualifikimi.
- Licence (te ekspertit/operatorit ekonomik)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, paisja me Liçense per Mbrojtjen nga Zjarri te leshuar nga QKL. Kodi 1.2.A. specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar referuar natyrës që parashikon projekti me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë është vendosur referuar zërave të punimeve të parashikuara në preventivin C/ 3 ”Detektimi i zjarrit”D “Instalime mekanike”, konkretisht në D/1 “ Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit”.

e)Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

Shofer 2 (dy)

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar dhe jo te figurojnë ne listepagesa).

Për realizimin e punimeve të gërmimit dhe shtresave në fushën sportive kërkohet staf i specializuar për operimin e mjeteve:

- Shofer me kamioncine veteshkarkuese deri ne 3.5 ton (1)

Eshte kerkuar 1 shofer kamioncine për drejtimin e kamionit vetshkarkues.

- Shofer per kamion me vinc >8m (1)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Eshte kerkuar 1 shofer per drejtimin e kamionit me vinç >8 m lartesi me kapacitet mbajtes 10-12 ton

Kjo ndarje e roleve mundëson funksionim të pandërprerë të proceseve, rrit eficiencën dhe garanton realizimin e punimeve sipas standardeve dhe afateve të kontratës.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënie e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- 1.3.4 2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore dhe staf kryesor prej **minimalisht 9 (nente) punonjes**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për muajin e fundit.

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit
Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Nr i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamionçinë me vetëshkarkim me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me vinc >8 m lartësi me kapacitet mbajtës 10-12 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera

Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore minimumi 9 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 3 copë
- Rrip sigurimi minimumi 7 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – jo më pak se 3 copë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

Argumentimi: *Kërkesat e mesiperme jane vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e meposhtëm :

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerese, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës
- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

“Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim”.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Funksioni
1	Kamionçinë me vetëshkarkim me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1 copë	Per transportin e materialeve të ngurtra dhe të ndertimit
2	Kamion me vinc >8 m lartesi me kapacitet mbajtes 10-12 ton	1 copë	Per sistemimin e territorit të jashtëm dhe pastrimin

Në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore minimumi 9 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 3 copë
- Rrip sigurimi minimumi 7 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – jo më pak se 3 copë

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

- SSH EN ISO **9001:2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), *ose ekuivalent*
- SSH ISO **45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose, *ose ekuivalentet*
- SSH EN ISO **14001-2015** (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

SSH EN ISO 9001:2015 është në seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptone për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogelimin e kostove. Pra ky certifikim do të bejë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me cmime të ulta.

SSH EN ISO 14001-2015 ofron një kuader praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

identifikoje impaktin ne mjedis gjate aktivitetit te saj si dhe te permiresoje performancen mjedisore duke zbatuar nje qasje sistematike. Pra ky certifikim do te beje te mundur qe Ofertuesit te ushtrojne veprimtarine duke pasur ne konsiderate parimin e mbrojtjes se mjedisit.

SSH ISO 45001-2018 eshte standard nderkombetare, i cili parashton kerkesat per menaxhimin e praktikave te mira te sigurise dhe shendetit ne pune per cdo organizate, pavaresisht nga madhesia. AK gjykon se cdo Ofertues duhet te jete i pajisur me ISO 45001-2018 me qellim qe veprimtaria e ushtruar nga ana tij (ne rastin konkret realizimi i punes objekt prokurimi) te realizohet duke u mbeshtetur mbi parimin e sigurise dhe shendetit ne pune. Kjo kerkese sherben dhe si nje garanci extra qe do te sjelle reduktimin e aksidenteve dhe semundjeve ne vendin e punes duke minimizuar kostot si dhe kohen ne permbushje me sukses te kontrates se punes objekt prokurimi.

2.3.10 Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” hartuar nga specialistet e urbanistikës për hartimin e projektit të zbatimit .

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës së specialistëve të drejtorisë së arsimit për hartimin e projektit të zbatimit , bashkëngjitur DST ne SPE.

Ne rastet kur ne specifikimet teknike janë kërkuar standartet si: “DIN 18055, DIN 181880, EN ISO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT BASHKIA BERAT

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***